



**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 778 / Prot.  
2

Rrëshen me, 26 . 02 . 2021

**V E N D I M**

**Nr. 16 datë 24. 02. 2021**

**PËR**

**“MIRATIMIN E KËRKESËS, PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË MIRDITË, TË PASURISË PALUAJTSHME SHTETRORE, E LLOJIT NDËRTESESË DHE TRUALL, ME NR. PASURIE 2/134, ZONA KADASTRALE 3224, (ISH GODINA SHISH), E CILA DO TË PËRDORET NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SOCIALE, NË FUNKSION TË BASHKISË MIRDITË”**

Në mbështetje nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1 germa “b”, pika 1.2 germa “a”, neni 24, neni 55, pika 2 dhe 6, e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8743, datë 22.01.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3, e ligjit nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM nr. 500, date 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 15, 30. 06. 2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore, të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të paluajtshme publike”, me propozim të kryetarit të bashkisë Mirditë i shoqëruar me relacion spjegues nga drejtoria juridike, pas shqyrtimit të projekt-vendimit dhe diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak Mirditë;

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të bashkisë Mirditë, të pasurisë paluajtshme shtetore e llojit ndërtesë dhe truall, me nr.pasurie 2/134, ZK 3224, (ish Godina Shish), e cila do të përdoret ne fushën e shërbimeve sociale, në funksion të bashkisë Mirditë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë, (drejtoria juridike, dhe drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit dhe strehimit).

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gasper TOPOLLAJ**



**KRYETAR**

**Pjeter PJETRI**

ADRESA: SHESHË “ABAT DOÇI”, RRESHEN



## BASHKIA MIRDITË

Nr. 778/  
Prot. 1

Rrëshen me, 17 . 02 . 2021

### RELACION

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË MIRDITË, TË PASURISË SË PALUAJTSHME SHTETËRORE E LLOJIT NDËRTESEË DHE TRUALL ME NR.PASURIE 2/134, ZONA KADASTRALE 3224, ( ISH GODINA E SHISH) E CILA DO TË PËRDORET NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SOCIALE NË FUNKSION TË BASHKISË MIRDITË”.**

### **DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË.**

Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Nisur nga nevojat e komunitetit të zonës së Mirditës, për të ofruar shërbime për fëmijët në përgjithësi, edukimin dhe socializimin e tyre, dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara në mënyrë të veçantë, për të mundësuar plotësimin e shërbimeve sociale dhe profesionale specifike për nevojat e tyre, është e domosdoshme krijimi i një “Qendre Ditore Multifunksionale Për Fëmijët”.

Fëmijët që do të marrin pjesë në këtë qendër janë sipas kategorive të përcaktuara:

- 1-Fëmijë që vijnë nga familje në nevoje.
- 2-Fëmijë me aftësi të kufizuara .
- 3-Fëmijë të grupmoshës 4 deri në 14 vjeç.

Gjithashtu në kuadër të miratimit të Planit Social të Bashkisë Mirditë 2021-2023, është një nga prioritetet edhe ofrimi i shërbimeve për këto kategori personash. Por realizimi i kësaj qendërë kërkon së pari ambjentet e domosdoshme për implementimin dhe zhvillimin e saj, prandaj Bashkia Mirditë ka shprehur interes për transferimin e pronës së Ish-Shërbimit Informativ Shtetëror e cila për momentin është jashtë funksionit.

Nisja e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Mirditë të pronës së sipërcituar kërkon së pari miratimin e kërkesës nga Këshilli Bashkiak , prandaj kërkojmë nga ana juaj votimin në seancën e radhës të këtij projekt-vendimi i cili do të na mundësojë në vijim vazhdimin e procedurave të tjera ligjore me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës deri në përfundimin e procedurës dhe kalimin e kësaj pronë në pronësi të Bashkisë Mirditë.

Hartoi relacionin:

J.KOLAJ

/Jurist/

**KRYETARI**

**Ndrec DEDAJ**



**SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE**

--> Vijon nga Vol \_\_\_\_\_, Fq. \_\_\_\_\_

Zona Kadastrale: 3224 NR.i PASURISE: 2/134

Vijon në: Vol \_\_\_\_\_, Fq. \_\_\_\_\_ deri në: Vol \_\_\_\_\_, Fq. \_\_\_\_\_ -->

Indeksi i Hartes: RRE-C-2

**PERFUNDIMTARE**(data): 14/7/2014

Adresa e Pasurisë: Rrethi MIRDITE Q/F RRESHEN

Rr/L \_\_\_\_\_ P/G \_\_\_\_\_ SH \_\_\_\_\_ K -1 Ap \_\_\_\_\_

Përshkrim i veçantë:

DIFERENCE FAKT-DOKUMENT=96M2  
1927



**B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE**

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N. : PO , Ref PL.RREG.

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtës
1. <u>470.00</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>00002425</u>	1. <u>470.00</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>00002425</u>	1. <u>145.40</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>00002425</u>
2. <u>566.00</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>LN2013</u>	2. <u>566.00</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>LN2013</u>	2. <u>154.00</u> m <sup>2</sup> Ref. <u>LN2013</u>
3. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	3. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	3. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____
4. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	4. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____	4. _____ m <sup>2</sup> Ref. _____

Per pjesen e përbashkët :
<u>PALLAT</u>
Kuota e pjesmarrjes: _____ %
Nr i Pasurise (pallat):
Vol _____ Faqe _____

**C - SEKSIONI I PRONESISE**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
LN 2013	20/05/2015	SHTET				I	ELBASAN				